



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

RAPORTI MBI REALIZIMIN E DETYRAVE TË CILAT DALIN NGA AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS
20 DHJETOR 2017
Prishtinë

PËRMBAJTJA

PËRSHKRIMI	3
E.1. Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në AKK	3
E.2 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatisë një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun e Kosovës, me rekomandimet e duhura.	5
TREGU I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE	6
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	10
TREGUN E ENERGJISË	11
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	14
TREGUN E SIGURIMEVE	15
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	17
TREGUN E IMPORTIT TE NAFTES	18
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	21
TREGU I PRODUKTEVE FARMACEUTIKE	22
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesional</i>	25
TREGUN E TRANSPORTIT	26
<i>Rekomandimet dhe mendimi profesional</i>	38
TREGUN E LOJARAVE TË FATIT	41
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesional</i>	42
TREGUN I MEDIAVE DHE PRODUKSIONEVE KINEMATOGRAFIKE	43
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesional</i>	46
TREGUN FINACIAR DHE BANKAR	48
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	50
TREGU I MINIERAVE DHE MINERALEVE	51
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	53
TREGU I PAJISJEVE FISKALE	54
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	55
TREGU I FURNIZIMIT ME UJË	56
TREGU I MBETURINAVE	60
<i>Rekomandimet dhe mendimet profesionale</i>	61

Raport mbi E.1 dhe E.2 të AGJENDËS PËR REFORMA EVROPIANE

Në mbështetje të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, 1.11, 1.12, neni 23, duke u bazuar në AGJENDEN PËR REFORMA EVROPIANE pika E.1 dhe E.2, duke u bazuar në Vendimin nr.22/17 të datës 04.08.2017 “Strategjia për Zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane dhe, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nxjerr këtë raport:

PËRSHKRIMI

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Marrëveshja është marrëdhënia e parë zyrtare kontraktuale që lidh së bashku BE-në dhe Kosovën. Ajo i ofron Kosovës mundësi dhe stimuj që të forcojë qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, si dhe të nxisë rritjen ekonomike dhe punësimin. Ajo siguron zhvillimin gradual të një zone të tregtisë së lirë me BE-në, mund të ndihmojë në tërheqjen e investimeve të huaja dhe të brendshme, dhe të përmirësojë mjedisin afarist.

Agjenda për Reforma Evropiane duhet të shihet si e ndërlidhur me Programin e Kosovës për Reforma Ekonomike, i cili i është dorëzuar Komisionit në janar 2016 dhe mbetet dokumenti kyç gjithëpërfshirës i politikave që udhëheq reformat makro-ekonomike dhe fiskale, përfshirë rekomandimet për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe zbutjen e trysnisë në tregun e punës.

Veprimet prioritare në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane janë identifikuar bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian, në konsultim të ngushtë me INF-të, sektorin e biznesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë.

“Plani i veprimit për zbatimin e prioriteteve kyçe” në kuader të ARE-se është pjesa kryesore integrale e këtij dokumenti (ARE), e cila parasheh prioritetet e përcaktuara nga qeveria dhe kuvendi për të filluar zbatimin e reformave ekonomike në të gjithë sektorët e shtetit.

Veprimet konkrete që duhet të kihen parasysh dhe të cilat janë pjesë e zbatimit të ARE-së, për fushëveprimtarinë e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës janë:

E.1 Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në AKK.

E.2 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatisë një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun e Kosovës, me rekomandimet e duhura.

E.1. Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në AKK

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duke i shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore, financiare dhe strategjike për fuqizimin e procedurave dhe kapaciteteve humane, ka arritur që ta kompletoj legjislacionin sekondar i përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Hartimi i legjislacionit sekondar vendos themelet ligjore për të filluar fuqizimin e procedurave dhe kapaciteteve humane. Në këtë rrafsh Autoriteti ka hartuar dhe aprovuar këto Udhëzime Administrative:

1. ***U.A PËR PËRJASHTIMET GRUPORE- MARRËVESHJET HORIZONTALE –***
 - a. marrëveshje horizontale është kontratë, një dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë apo me shkrim, praktikat e bashkërenduara, që rezultojnë nga marrëveshje të tilla, vendime të ndërmarrësve apo të grupeve të ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme të biznesit dhe aktet tjera të ndërmarrësve, që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes dhe të ngjashme, të

arritura ndërmjet dy apo më tepër ndërmarrësve të pavarur të cilët veprojnë **në nivel të njëjtë të prodhimit**, gjegjësisht distribuimit, dhe të cilëve u rregullohen kushtet me të cilët palët e marrëveshjes mund të blejnë, shesin apo rishesin mallrat dhe/apo shërbimet e caktuara;

2. **U.A PËR PËRJASHTIMET GRUPORE- MARRËVESHJET VERTIKALE –**
 - a. Marrëveshje vertikale- është kontratë, ndonjë dispozitë e kontratës, marrëveshjet gojore ose me shkrim, praktikat e bashkërenduara që rezultojnë në marrëveshje të tilla, vendimet nga ndërmarrësit ose shoqatat e ndërmarrësve, kushtet e përgjithshme dhe aktet tjera të ndërmarrësve, të cilat janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës, të lidhura ndërmjet palëve **që nuk veprojnë në të njëjtin nivel të prodhimit ose të shpërndarjes**, e të cilave i'u parashtrohen kushtet me të cilat pjesëmarrësit në marrëveshje mund të blejnë, shesin apo rishesin mallra dhe / ose shërbime të caktuara;
3. **U.A PËR PËRJASHTIMIN GRUPOR TË MARRËVESHJEVE NË SEKTORIN E TRANSPORTIT –**
 - a. Ky Udhëzim Administrativ, përcakton kushtet që marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve, të cilat rregullojnë transportin rrugor dhe hekurudhor duhet t'i përmbajnë, si dhe kufizimet ose kushtet që marrëveshjet e tilla nuk mund t'i përmbajnë në mënyrë që të jenë të përjashtuara në grup nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4, të Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrësve që rregullojnë transportin ajror nuk mund të përjashtohen në grup në kuptim të këtij Udhëzimi, por mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4, të ndryshim plotësimi të Ligjit dhe nëse në mënyrë kumulative gjatë kohëzgjatjes së tyre i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4, të ndryshim plotësimi të Ligjit.
4. **U.A PËR PËRJASHTIMIN GRUPOR TË MARRËVESHJEVE NË SEKTORIN E SIGURIMEVE –**
 - a. Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohen kushtet të cilat duhet ti përmbushin marrëveshjet e sigurimeve, si dhe kufizimet ose kushtet që këto marrëveshje nuk mund ti përmbajnë, në mënyrë që të jenë në gjendje të përjashtohen në formë grupore nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4 të ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Kompania e sigurimeve nën kontroll të kompanisë tjetër të sigurimeve ose kompania e përqendruar, krijohet sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 1.2 e Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës nëpërmjet të kontrollit të drejtpërdrejt apo të tërthortë ose me ndikimin e pozitës dominuese të një apo më shumë ndërmarrjeve (kompanive të sigurimeve) apo pjesëve të ndërmarrjeve (kompanive të sigurimeve).
5. **U.A. PËR PËRJASHTIMIN GRUPOR TË MARRËVESHJEVE NË SEKTORIN E DISTRIBUIMIT DHE SERVISIMIT TË MJETEVE MOTORIKE**
 - a. Marrëveshje vertikale në sektorin e distribuimit dhe servisimit të automjeteve motorike është një kontratë, dispozitë e caktuar e kontratës, marrëveshje me gojë ose me shkrim dhe një praktikë e bashkërenduar që rezulton nga marrëveshje të tilla, vendim nga një ndërmarrës ose shoqatë ndërmarrësish, kushtet e përgjithshme të afarizmit dhe akte të tjera të ndërmarrësve që janë ose mund të jenë pjesë përbërëse e kontratës dhe të ngjashme, të lidhura ndërmjet ndërmarrësve që nuk operojnë në të njëjtin nivel të prodhimit, ose distribuimit dhe me të cilën rregullohen kushtet në të cilat palët në marrëveshje mund të blejnë, shesin ose rishesin automjete motorike të reja, pjesë rezervë për automjete motorike ose ofrojnë shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje të automjeteve motorike;

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka kërkuar nga Ministria e Financave, ta rris buxhetin në kategoritë ekonomike e sidomos në kategorinë ekonomike "Pagave dhe Meditjeve" dhe ta lejojë Autoritetin të zhvillojë procedura rekrutuese për ngritjen e burimeve njerëzore. Deri më tani Ministria e Financave nuk i ka zbatuar apo marr për bazë kërkesat e Autoritetit. Kërkesat tona kanë qenë te argumentuara, të arsyshme dhe tërësisht në kuadër të mundësive buxhetore. Nga se u tha me lartë, në i kemi adresuar kërkesat tona Kuvendit të RKS-së përkatësisht Komisionit për Buxhet dhe Financa. Kërkesa e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është aprovuar nga Komisioni për buxhet dhe financa me pëlqimin e Ministrit të Financave.

Kemi zhvilluar takime të njëpasnjëshme me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, Ambasadat e Kuintit dhe të tjera në ndërtimin e marrëdhënjeve profesionale. Kemi kërkuar ndihmën dhe ekspertizën e tyre në ofrimin e trajnimeve profesional, inkuadrimit e ekspertëve të huaj, vizita studimore në institucionet si motra etj. Kemi krijuar bashkëpunim

të mirëfilltë dhe profesional me Ministrinë e Integriteteve Evropiane meqenëse ata janë bartës dhe mbikqyrës të drejtëpërdrejtë të implementimit të MSA-së dhe të gjitha format tjera që ndërlidhin institucionet e vendit me Bashkimin Evropian. Autoriteti ka shfrytëzuar mekanizmin ndihmues TAIEX, për ofrimin e ndihmave të shpejta profesionale për çështje interne të Autoritetit.

Ngritja e kapaciteteve humane duhet të realizohet përmes rekrutimit të stafit dhe trajnimeve të ndryshme profesionale për stafin aktual. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përkatësisht Departamenti i Mbikqyrjes së Tregut ka 5(pesë) inspektor hetues, të cilët duhet ta mbulojnë tërë tregun gjeografik të Republikës së Kosovës dhe më këtë numër të vogël të inspektorëve, është e pamundur fizikisht të monitorohet dhe inspektohet i tërë tregu i Republikës së Kosovës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka kërkuar nga Ministria e Financave që ta bëjë rritjen e buxhetit dhe lejimin e rekrutimit të stafit për:

- a. Dy (3) Inspektor Hetuese (Jurist dhe Ekonomist)
- b. Nje (1) Inspektor Hetuese (Teknologji Informativ)
- c. Dy (3) analista të tregut (Jurist dhe Ekonomist)

Ndërsa tek mallrat dhe shërbimet në buxhetin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, kemi kërkuar që të ketë ngritje sistematike buxhetore, në përputhje me ngritjen e aktiviteteve të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Duhet të kihet parasysh aktivitetet e llojllojshme të avokimit (workshope, konferenca regionale të organizuara në Kosovë, trajnime të ndryshme etj.)

E.2 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatisë një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun e Kosovës, me rekomandimet e duhura.

AGJENDA PËR REFORMA EVROPIANE përkatësisht pika E.2 ngarkon Autoritetin Kosovar të Konkurrencës të hulumtojë dhe përgatisë një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun e Kosovës, me rekomandimet e duhura.

Hulumtimi i tregut për identifikimin e monopoleve në Republikën e Kosovës është detyra kryesore e Autoritetit e përcaktuar në ARE.

Mënyrën e përcaktimit të Pozitës Dominuese dhe Monopoleve, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës e ka bërë duke u bazuar në qarkullimin vjetor të ndërmarrjeve që operojnë në të njëjtin treg, përpjestuar me qarkullimin vjetor të ndërmarrjes specifike.

E NJOFTOJMË Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë dhe Komisionin Evropian, se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka bërë hulumtimin dhe identifikimin e monopoleve në Republikën e Kosovës për 14 tregje dhe njëkohësisht ka nxjerr informata mbi strukturën e tregut të ndërmarrjeve dhe pozitën e tyre dominuese të përcaktuar me LIGJIN Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS.

Tregu i Telekomikacionit	Tregu i Energjise	Tregu i Sigurimeve	Tregu i derivateve të naftës	Tregu i produkteve farmaceutike
Tregu i Transportit	Tregu i mediave dhe produksioneve kinematografike	Prokurimi ¹	Tregu i sektorit bankar	Tregu i paisjeve fiskale
Tregu i lojrave te fatit	Tregu i minierave	Tregu i mbeturinave	Tregu i funizimit me Uje	

¹ Treg nuk mund të konsiderohet Prokurimi. Por Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka bashkëpunuar për të afërmi me KRPP-ne rreth tenderimeve që behen nga Organizatat Buxhetore, dhe marrjen e informacioneve të kompanive të cilat kanë fituar në Tenderet Publike.

TREGU I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Në tregun e komunikimeve elektronike, numri i operatorëve, të cilët janë regjistruar në regjistrin e autorizimeve të përgjithshme është 98 me gjithsej 205 aktivitete, ndërsa në tregun e shërbimeve postare operojnë aktualisht gjithsejtë 14 Operatorë postar.

Tregu i komunikimeve elektronikë është një nder tregjet me dinamikë dhe konkures.

Shfrytëzimi i komunikimeve elektronike vazhdon me trende pozitive të zhvillimeve, referuar rritjes se vellimit të trafikut dhe investimeve të konsiderueshme në zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve ekzistuese (infrastruktura telekomunikuese), ofrimin e shërbimeve të gjeneratave të reja përmes teknologjive mobile të njohur si 3G dhe 4G. Por verehet renja e të hyrave financiare në tregun e telefonise mobile dhe fikse, dhe rritjen e të hyrave nga shërbimet e internetit dhe shërbimeve kabllore.

Të hyrat nga shërbimet e Komunikimeve elektronike për vitin 2016 arrin vleren **168,347,895 Euro**, operatorët e telefonise mobile dhe ofruesit e shërbimeve të internetit zoterojnë pjesen më të madhe të tregut të telekomunikimeve elektronike me rreth 80% të të ardhurave, operatorët mobil përbejnë 66.7% të të ardhurave të të gjithë tregut duke u përcjellur nga ofruesit e shërbimeve të internetit me 13.36% televizioni kabllor 14.12% ndërsa operatorët fiks 5.53%.

Përdorimi i telefonisë mobile nder vite vazhdon të kete rritje të numrit të përdoruesve, Në fund të vitit 2016 numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur mbi 2 milion përdorues.

Qasja në Internet për qytetaret e Republikës së Kosovës deri në vitin 2016 ofrohet nga 52 ndërmarrje të autorizuar 4 prej tyre kanë qasje të drejtpërdrejt në daljet ndërkombetare international Gateway, të cilat ofrojnë qasje në rrjetin e internetit të ISP-ve me të vogla e që veprojnë në rajonet me të ndryshme të Kosovës.

Trafiku i përgjithshëm i internetit ofrohet nga 4 operatorët e lidhur në nje shkembuese të internetit të Kosovës (KOS-IX) të themeluar si njësi teknike pran Autoritetit me qasje në rrjetin ndërkombetare; Telekom i Kosovës, IPKO Telecommunication, Kujtesa net dhe NTSH Art motion, totali i trafikut të internetit nga keta operator është 111 Gbps.

Vlerësohet se në Kosove mbi 30% e përdoruesve e telefonisë mobile shfrytëzojnë telefona të menqur mobil të cilët mundëson dhe përkrahin përdorimin e aplikacionit të internetit.

Tregu i Telefonis Fikse vazhdon të zhvillohet me ritëm të ngadalësuar dukuri e ngajshme edhe në shtetet e rajonit dhe ato Evropiane ku është vërejtur ngadalësim, sidomos në rritjen e penetrimit dhe të hyrave të përgjithshme.

Të hyrat në shërbimet postare të raportuara nga operatorët postar kanë qenë në vleren prej 5,857,040.61 Euro me nje rritje të qendrueshme të tregut të shërbimeve postare në Republikën e Kosovës. Posta e Kosovës SH.A zoteron tregun me 67.10% të të hyrave në sektorin postar, ndërsa operatorët privat me 32.9% të të hyrave të përgjithshme.

Posta e Kosovës Sh.A. është operator publik postar, gëzon të drejtën ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të rezervuara postare edhe për nje periudhe të caktuar kohore

Qëllimi i Ligjit Nr.04/L-109 për Komunikimet elektronike është rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.

Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike bazohet në parimin e menaxhimit dhe përdorimit efektiv të resurseve të kufizuara, neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kritereve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mos-diskriminim.

Pra, ARKEP në procesin e rregullimit të tregut i trajton në mënyrë të barabartë të gjitha ndërmarrjet dhe nuk i diskriminon mbi bazën e ndarjes në mes publike apo private.

Sa i përket ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), ARKEP në përputhje me Kornizën Rregullatore, pas procesit të analizës së tregut, u vendos detyrime shtesë (Rregullimi asimetrik *ex-ante*), ashtu që të mos abuzojnë me pozitën që kanë.

Sa u përket tregjeve, subjekt i analizës dhe rregullimit *ex-ante*, njëra nga detyrimet rregullatore të vendosura nga ARKEP është detyrimi i kontrollit të çmimit dhe llogaritjes së kostos sipas dispozitave të nenit 35 të Ligjit të Komunikimeve elektronike dhe Rregullores nr.27 për analizat e tregut. Në përcaktimin e çmimit ekzistojnë modele të ndryshme, të cilat aplikohen si: pure LRIC, metoda e shpërndarjes së plotë e kostos (FDC), efikasitetit krahasues (Benchmarking), etj.

ARKEP deri më tani në procesin e analizës dhe rregullimit të tregjeve ka aplikuar metodën FDC dhe efikasitetit krahasues përmes aplikimit të modelit të përshkallëzimit gradual (Glide Path).

Siç është theksuar më lartë, Korniza aktuale rregullatore ka eliminuar barrierat e panevojshme për hyrje në treg nga investitorët e ri. Regjimi i licencave individuale është zëvendësuar me regjimin e autorizimeve të përgjithshme.

Sa u përket resurseve të kufizuara (numerike dhe frekuencore), aplikohen autorizimet individuale, përkatësisht pagesa të caktuara.

Duke pasur parasysh faktin se të hyrat e operatorëve janë duke pësuar rënie (kryesisht nga telefonia mobile dhe fikse), si sfida kryesore e adresuar është zvogëlimi i tarifave të resurseve të kufizuara (frekuencore dhe numerike). ARKEP gjatë këtij viti me miratimin e rregullores së re për planin e numeracionit ka zvogëluar për 40% pagesat vjetore për resurse numerike, përderisa është në proces të rishikimit të tarifave vjetore dhe ato të njëhershme (one-off) për resurse frekuencore.

Prezenca e më shumë se një operatorë në treg për ofrimin e produkteve/shërbimeve të ngjashme, konsiderohet se tregu është konkurrues.

Megjithatë ARKEP pas procesit të Analizës së tregut me qëllim të eliminimit të barrierave për hyrësit e ri në treg ka vendosur detyrime rregullatore *ex-ante* për ndërmarrjen me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse:

Telefoni fikse

Tregjet me pakicë:

- a) Qasja në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse
- b) Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun, të ofruara në lokacionin fikse
- c) Shërbimet telefonike ndërkombëtare të disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fikse

Tregjet me shumicë:

- a) Origjinimi i thirrjeve në rrjetin publik telefonik të ofruara në një lokacion fikse
- b) Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fikse
- c) Shërbimet transite në rrjetet publike telefonike fikse
- d) Qasjen me shumicë në Infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë qasjen e ndarë, të pjesshëm dhe të plotë) për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese

Telefoni mobile:

Tregjet me shumicë:

- a) Terminimi i thirrjeve në rrjetet individuale mobile

ARKEP është në proces të Analizës së tregut Qasjes me shumicë Brezgjërë (Broadband) dhe Qasjen me shumicë në Infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë qasjen e ndarë, të pjesshëm dhe të plotë) për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese.

Në tregun e shërbimeve postare konkurrenca është mjaftë e madhe ndermjet operatorve.

Monopolet natyrore tek tregu i komunikimeve elektronike dhe postare.

Komunikimet Elektronike: Përveç tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse dhe mobile, të cilët për shkak të pengesave teknologjike konsiderohet si monopol natyror, në tregjet tjera të komunikimeve elektronike konsiderohet se tregu është konkurrues në nivel shërbimi, madje në tregun e shërbimeve të internetit dhe telefoni fikse tregu është konkurrues edhe në nivel të infrastrukturave prezentë në treg (të gjithë operatorët në treg operojnë bazuar në infrastrukturën vetanake), ndersa tek :

Shërbimet Postare: Ligji për shërbime postare paraqet një monopol në shërbime të postës së letrave të thjeshta deri 1 kg. ARKEP ka ndërmarr masa dhe veprime në këtë drejtim duke reduktuar peshën për këtë shërbim nga data 1 Janar 2014 nga pesha 1 kg, në 500 gram, dhe nga data 1 Janar 2016 në masën 100 gram.

Vlen të theksohet se bazuar në Marrëveshjen e Telekomunikacionit e arritur në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ARKEP për ndërmarrjen “mts” D.O.O ka lëshuar: Autrizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse dhe Autorizimin e përkohshëm për Ofrimin e rrjetit publik mobil i kufizuar në operime dhe infrastrukturë në përputhje me pikën 4.0 të Marrëveshjes së Telekomunikacionit.

Gjithashtu, ARKEP ka realizuar matje në teren dhe ka verifikuar se ndermarreja, Telenor, Vip mobile kanë ndërprer ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Kosovës .

<i>Tregu i telekomunikacionit në Republikën e Kosovë ndahet 4 (katër) sektor:</i>
<ol style="list-style-type: none"><i>1. Sektori i shërbimeve fikse</i><i>2. Sektori shërbimeve mobile</i><i>3. Sektori ofrimit të internetit.</i><i>4. Sektori i shërbimeve postare.</i>

1. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Shërbimet e Telefonisë Fikse

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SEKTORIN E SHËRBIMEVE FIKSE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SEKTORI I SHËRBIMEVE FIKSE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Telekomi i Kosovës Sh.A ish PTK,	80%	Pozite dominuese
2. Ipko telecommunications LLC	18%	Nuk ka PD
3. Kujtesa.net	2%	Nuk ka PD
4. Fiberlink	0%	Nuk ka PD
Gjithsej:	100%	

2. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Shërbimet e telefonisë Mobile

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SEKTORIN E SHËRBIMEVE MOBILE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SEKTORI I SHËRBIMEVE MOBILE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Telekomi i Kosovës SH.A /Vala	59.8%	Pozite dominuese
2. IPKO Telekomunication LLC	32.6%	Pozite dominuese
3. Dardafon.net LLC (Z-mobile)	7.6%	Nuk ka PD
4. <i>Dukagjini Telekomunication SH.A.(D3 mobile)</i>	0 %	Nuk ka PD
Gjithsej:	100%	

3. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Shërbimet e Internetit

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SEKTORIN E OFRIMIT TE INTERNETIT</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SEKTORI I OFRIMIT TE INTERNETIT</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Ipko	48%	Pozite dominuese
2. Kujtesa Net	25%	Pozite dominuese
3. Telekomi i Kosovës	14%	Nuk ka PD
4. Art motion	2 %	Nuk ka PD
5. Të Tjerët	11 %	Nuk ka PD
Gjithesej:	100%	

4. Tregu Relevant:
- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
 - Tregu i Produktit – Shërbimeve postare

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SEKTORIN E OFRIMIT TE SHËRBIMEVE POSTARE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SEKTORI I OFRIMIT TE SHËRBIMEVE POSTARE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Posta e Kosovës Sh.A.	67.10 %	Pozite dominuese
2. Sh.P.K DHL	17.17 %	Nuk ka PD
3. NTSH KCC-TNT	8.11 %	Nuk ka PD
4. Korier Express KOEX SHPK	3.18 %	Nuk ka PD
5. Al Dushi SH.P.K UPS	1.86 %	Nuk ka PD
6. 6 Operator Tjerë Ekonomik	2.58 %	Nuk ka PD
Gjithsej:	100%	

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Tregu i komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare në përgjithësi është konkurrues, në veçanti tregu i telefonisë fikse edhe përkundër se kemi një operator me pozitë dominuese megjithatë, tregu është i rregulluar nga ARKEP duke vendosur detyrime rregullatore.

Tregu i telefonisë mobile edhe përkundër përqendrimit të tregut në dy operator të rrjetit megjithatë tregu është konkurrues në nivel shërbimi, duke pas parasysh faktin se ekzistojnë dy operator virtual (MVNO) ku njëri prej tyre është mjaft aktiv në treg. Si dhe prezenca e operatorit me infrastrukturë të kufizuar kontribuon që ky treg të jetë deri në një masë konkurrues.

Mirëpo, duke pas parasysh faktin se ka brez të mjaftueshëm frekuencor, rekomandojmë që ky brez të hapet dhe të mundësohet zhvillimi i mëtutjeshëm i rrjeteve dhe shërbimeve, i cili do të ndikojë në dinamizmin e mëtutjeshëm të këtij tregu.

Tregu i shërbimeve të internetit konsiderohet si treg konkurrues në nivel të infrastrukturës pasi që secili operator ofrimin e shërbimeve e bazon në infrastrukturën vetanake (mbi 54 oper). Megjithatë marr parasysh konvergjencën e teknologjive e cila mundëson ofrimin e shërbimeve në pako atëherë çështja është e ndjeshme kur behet fjale për ofrimin e shërbimeve të internetit në pako me shërbimet e transmetimit të përmbytjes.

Operatori Ipko i cili përben 48% të tregut të ofrimit të qasjes në internet, ofron shërbime në pako internet dhe transmetim i përmbytjes. Transmetimi i përmbytjes behet në baze të marrëveshjes ekskluzive mes Ipko dhe DigitAlb, si rrjedhojë ky ekskluzivitet në masë të gjerë ka ndikim dhe i jep pozitën dominuese Ipko-s në tregun e shërbimeve të internetit.

Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGUN E ENERGISË

Tregu i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës ka filluar të liberalizohet me hyrjen në fuqi të pakos së tretë të ligjeve. Në këtë kuptim ZRRE ka ndërmarr të gjitha aktivitetet e nevojshme për të krijuar kornizën e nevojshme ligjore dhe rregullative si parakusht për këtë proces.

Zyra e Rregullatorit për Energji është i vetmi organ i cili ka përgjegjësi ligjore të promovoj tregun e brendshëm konkurrues të energjisë, duke siguruar hapjen efektive të tregut për të gjithë konsumatorët dhe furnizuesit dhe krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin efektiv të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë.

Gjithashtu edhe në kuadër të obligimeve ndërkombëtare (si pjesë e Komunitetit të Energjisë), Rregullatori ka përgjegjësi që të zhvilloj tregjet konkurruese dhe funksionale brenda Kosovës.

Sektori i energjisë elektrike para aprovimit të ligjeve të pakos së tretë ka qenë tërësisht i rregulluar, tani Rregullatori, disa nga aktivitetet të cilat kanë qenë të rregulluara ka vendosur që të veprojnë në kushtet e tregut të energjisë elektrike.

Tregu i energjisë i mbikëqyrur nga ZRRE i trajton në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të licencuar nga Rregullatori të cilët veprojnë në sektorin e energjisë, pavarësisht pronësisë shtetërore apo private, trajtohen në pajtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencat përkatëse. ZRRE është përgjegjëse për monitorimin e operimit të tregjeve të energjisë elektrike, termike dhe gazit natyror, në mënyrë që të sigurojë funksionimin efikas të këtyre tregjeve. Gjithashtu, edhe politikat, çmimet dhe aksionet për ndërmarrjet qofshin ato në pronësi publike apo private kanë trajtim të barabartë në aspektin rregullatorë.

Monopole natyrore konsiderohen rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes të cilat janë të definuara me legjislacionin në fuqi të sektorit të energjisë, për këtë arsye çmimet e të tyre janë të rregulluara. Ndërsa sa i përket monopolit për ndonjë produkt të veçantë nuk ka.

Operatorët Ekonomik të cilët veprojnë në tregun e energjisë elektrike në Kosovë janë:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK),
- Operatori i Transmetimit dhe Tregut (KOSTT),
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS),
- Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike KESCO,
- HC Ibër Lepenc,
- HC KELKOS Energy dhe
- gjeneratorët e vegjël të kyçur në shpërndarje.

Po ashtu janë edhe dy të licencuar për furnizim me energji elektrike HEP dhe GSA të cilët deri me tani nuk janë aktivë.

Operatorët Ekonomik që veprojnë në tregun e energjisë termike (ngrohjes qendrore) janë:

- NQ Termokos që kryen funksionin e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike (ngrohjes qendrore) për Komunën e Prishtinës;
- NQ Gjakova që kryen funksionin e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji termike (ngrohjes qendrore) për Komunën e Gjakovës.

Hapat që janë ndërmarr për hapjen e tregut:

Si hap konkret për hapjen e tregut në nivel të furnizimit me pakicë, Rregullatori ka miratuar Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut. Në të janë të vendosura kriteret dhe afatet kohore për hapjen e tregut të energjisë. Një nga aktivitetet të cilat tani më i nënshtrohen kushteve të tregut është edhe aktiviteti i gjenerimit (prodhimit) të energjisë elektrike. Çmimet (tarifat) e prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratori KEK SH.A nga 1 prilli i vitit 2017 nuk janë të rregulluara.

Si hap tjetër i hapjes së tregut është edhe aktiviteti i furnizimit me energji elektrike, i cili aktivitet tani më ushtrohet përmes operatorëve të licencuar nga ZRRE për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, ku deri më tani janë tre furnizues të licencuar nga Rregullatori.

Rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes janë monopole natyrore, ndërsa gjenerimi dhe furnizimi janë aktivitete konkurruese.

Rreth 95% e energjisë së prodhuar në vend vjen nga njësitë gjeneruese të KEK-ut, 5% e prodhimit vjen nga njësitë tjera gjeneruese siç janë HC Ujmani/Ibër Iepenci, HC Lumëbardhi/KELKOS Energy dhe gjeneratorë tjerë të kyçur në shpërndarje. Kjo energji e prodhuar në vend blihet nga Furnizuesi KESCO në përputhje me marrëveshjet për shitblerje të energjisë dhe shitet tek të gjithë konsumatorët e vendit, përjashtuar vetëm Feronikelin i cili energjinë e blen në treg me tarifa të parregulluara. Për të mbuluar konsumin KESCO importon energji prej 12-15%. Rrjeti i transmetimit dhe i shpërndarjes janë monopole natyrore, këto rrjete mbulojnë 100% territorin e Republikës së Kosovës. Furnizuesi KESCO momentalisht furnizon 100% konsumatorët, dy furnizues të tjerë të cilët janë të licencuar për të kryer aktivitetin e Furnizimit nuk janë aktiv.

Çmimet për entitetet e rregulluara përcaktohen nga ZRRE-ja që në rastin tonë janë KOSTT dhe KEDS, si dhe çmimet e furnizuesit që i obligohet detyrimi i shërbimit publik. Sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për Ndërrimin e Furnizuesit, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre, respektivisht edhe mundësinë e zgjedhjes së çmimit. KEK përcakton çmimin e produktit nga 1 prilli 2017. ZRRE-ja përcakton tarifa nxitëse për të gjithë operatorët të cilët janë në skemën mbështetëse për burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Tregu i Energjisë në Republikën e Kosovës ndahet në 4 (katër) sektor:

1. **Spektori i Prodhimit**
2. **Spektori i shpërndarjes**
3. **Spektori i furnizimit**
4. **Spektori transmisionit.**

1. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Sektori i prodhimit

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SEKTORIN I PRODHIMIT</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SEKTORI I PRODHIMIT</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	95%	Pozite dominuese
2. HC Ujmani / Iber Lepenci, HC Lumëbardhi/KELKOS Energy dhe gjenerator tjetër të kyçur në shpërndarje	5%	Nuk ka PD
Gjithsej:	100%	

2. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Sektori i shpërndarjes

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në SEKTORIN E SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në SEKTORIN E SHPËRNDARJES DHE FURNIZIMIT</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Operatori i Sistemit të shpërndarjes KEDS	100%	Monopol natyror

3. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Tregu i furnizimit

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në SEKTORIN E FURNIZIMIT</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në SEKTORIN E FURNIZIMIT</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Kompania Kosovare për furnizim me energji elektrike KESCO	100%	Monopol
2. HEP dhe GSA	0 %	

4. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Sektori transmisionit

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në Sektori i transmisionit.</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve Sektori i transmisionit.</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Operatori i transmetimit të tregut KOSTT	100%	Monopol natyror

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se nuk ka konkurrencë të mjaftueshme në furnizim. Për momentin janë tre furnizues të licencuar për të furnizuar të gjithë tregun me pakice të energjisë elektrike në Kosovë por nga gjendja në treg konstatojmë se dy nga këta furnizues nuk janë bërë plotësisht aktiv prandaj nga gjendja aktuale konstatohet se KESCO ende ka 100% të pjesëmarrjes në treg, e cila tregon se tregu është i koncentruar vetëm në një furnizues dhe nuk ekziston konkurrenca efektive në tregun përkatës.

Te respektohet përcaktimi i çmimeve në pajtim me rregullat e aprovuara nga ZRRE-se. Kostot për ofrimin e shërbimeve të konsumatorëve (tarifat) duhet të reflektojnë kostot e arsyeshme, transparente dhe jo diskriminuese.

Çmimet për furnizimin me energji elektrike duhet të marrin për bazë kushtet konkurruese (blerjet e energjisë), elementet e performancës së produktivitetit, si dhe krahasimet me tregjet e ngjashme të industrisë në rajon.

Autoriteti rekomandon transparencë që gjatë sigurimit të energjisë elektrike të përdoren praktikat më të mira të ofruara edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjis dhe vendeve antare.

Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGUN E SIGURIMEVE

Në tregun e sigurimeve operojnë gjithsej 15 operator ekonomike/ sigurues, prej të cilëve 12 janë sigurues jojetë, ndërsa 3 sigurues jetë.

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë', i cili përfaqëson 96.9 % të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur prej 3.1 % përbëhet nga sigurimet 'jetë'.

Tregu i sigurimeve në Kosovë gjatë vitit 2016 kishte qarkullim në shume prej 83,509.000 Euro nga të cilat 80,889.000 Euro janë prime te shkruara nga sigurimet jo jete ndersa 2,621,00 Euro për pjesen e primeve te shkruara nga sigurimet jete.

Sa i përket produktit të autopërgjegjësishë, kjo është e rregulluar me rregulloren për strukturën e primit, në të cilën rregullore përcaktohet struktura e primit, që siguruesi duhet të zbatojë në caktimin e primit për sigurimin e detyrueshëm. Ndërsa sa i përket produkteve tjera vullnetare, çmimet caktohen sipas analizave dhe llogaritjeve aktuariale individuale të Siguruesve, dhe të cilat mund të dallojnë.

Kushtet për licencimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime janë të përcaktuara me Ligjin nr. 05/L-045 për Sigurimet. Mënyra e funksionimit të operatorëve të rinj në tregun e sigurimeve përcaktohet sipas strategjisë së vetë siguruesit, përndryshe kërkesat ligjore janë të ngjashme për secilin sigurues, pavarësisht a është i ri apo më gjatë në treg.

Duke qenë 12 sigurues jojetë dhe 3 sigurues jetë, në tregun e sigurimeve ekziston konkurrencë e mjaftueshme në tregun e sigurimeve jojetë.

Neni 7 paragrafi 4 i Ligjit për Bankën Qendrore dhe neni 4 i Ligjit për Sigurimet ka të përcaktuar objektivat dhe përgjegjësitë e BQK-së ku është e përcaktuar se Banka Qendrore vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve, përkatësisht të sigurojë një konkurrencë të drejtë dhe të rregullt, duke inkurajuar në këtë mënyrë zhvillimin, shtrirjen e produkteve dhe shërbimeve të sigurimit në dobi të mirëqenies publike, si dhe krijimin e një ambienti të përshtatshëm për investitorët potencialë në industrinë e sigurimeve në Kosovë.

Në treg nuk ekziston asnjë kufizim ligjor. Secili ka të drejtën të zgjedh cilindo sigurues që do.

Tregu i sigurimeve në Kosovë ka shenuar rritje, qoft në aspektin e rritjes se numrit te kompanive qoft në aspektin e bruto primeve te shkruara dhe te asetëve në përgjithësi.

Kompanitë me pronësi të huaj përbëjnë 50.2 përqind të gjithsej asetëve, ndërsa kompanitë vendore kanë një pjesëmarrje prej 49.8 përqind në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve.

Në vitin 2016, është aprovuar shitja e një kompanie me pronësi të huaj tek pronarët vendor dhe hapja e një kompanie të re me aksionar vendor, gjë që u reflektua edhe në strukturën e asetëve sipas pronësisë.

Si rrjedhojë, në sektorin e sigurimeve tashmë operojnë shtatë kompani me pronësi vendore dhe tetë kompani sigurimi me pronësi të huaj. Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve mund të konsiderohet e ulët, sidomos në krahasim me shkallën e koncentrimit të tregut bankar. Shprehur përmes pjesëmarrjes së tri kompanive më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve, shkalla e koncentrimit qëndroi në 33.3 përqind në vitin 2016, që paraqet një nivel të ngjashëm me vitin paraprak.

Konkurrenca në tregun e sigurimeve paraqet treg te zhvilluar te sigurimit me te cilën harmonizohet oferta dhe kërkesa “për sigurim” në ndonjë hapësire dhe kohe dhe atë: sipas llojit, cilësisë dhe sasisë, me ç’rast kjo mbulesë është e llojllojshme nga se objektet e sigurimit dhe rreziqet janë te ndryshme.

Karakteristikat e tregut te konkurrencës te sigurimit përkatësisht për funksionimin e tij janë:

- homojeniteti
- transparencja
- vendosja e parimeve ekonomike, preferenca kohore dhe hapësinore

Industria e sigurimeve definohet si formë e përcaktimit të sigurisë, garancisë vet besimit për jetën njerëzore dhe afarizmit të subjekteve të ndryshme ekonomike. Si detyrë më rëndësi është që me shërbimet e saja të krijoj një imazh të mirë në këtë lëmi me kusht që klientela të ndihet mirë dhe e sigurt për të papriturat e mundshme. Së dyti, kompanitë e sigurimit duhet që vazhdimisht të përcjellin dhe të dinë se ç’ka ndodhë në tregun e sigurimeve, në mënyrë që në bazë të kësaj të mund të zhvilloi veprimtarinë dhe të jetë prezentë në atë lëmi.

Tregu i Sigurimeve në Republikën e Kosovë ndahet 2 (dy) sektor:

1. Sigurimi jete
2. Sigurimi jo jete

1. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës se Kosovës
- Tregu i Produktit – Sigurimi jete

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve te cilat operojnë në tregun Sigurimit jete</i>	<i>Struktura e tregut te ndërmarrjeve Te sigurimit jete</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Illyria Life	64.6 %	Ka PD
2. Sigal Kosova Life	29.1 %	Ka PD
3. Grave Life	6.3 %	Nuk ka PD
Gjithsej:	100%	

2. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës se Kosovës
- Tregu i Produktit – Sigurimi jo jete

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve te cilat operojnë në Sigurimin jo jete</i>	<i>Struktura e tregut te ndërmarrjeve Në sigurimin jo jete</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Eurosig	15.3 %	Nuk ka PD
2. Sigal UGA	13.0 %	Nuk ka PD
3. Sigma VIG	12.0 %	Nuk ka PD
4. Elsig	9.8 %	Nuk ka PD
5. Illyria	8.8 %	Nuk ka PD
6. Siguria	8.4 %	Nuk ka PD

7.	Prisig	8.4 %	Nuk ka PD
8.	Kosova e re	7.1 %	Nuk ka PD
9.	Scardian	6.7 %	Nuk ka PD
10.	Dukagjini	4.1 %	Nuk ka PD
11.	Insig	3.6 %	Nuk ka PD
12.	Sig Kos	2.8 %	Nuk ka PD
	Gjithesej:	100 %	

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Çmimi i policave të sigurimit të detyrueshëm janë çmime standarde, të përcaktuara nga BQK-ja, të aplikueshme nga të gjithë.

AKK i rekomandom Bankës Qendrore të Kosovës si rregullator dhe Organ mbikqyres i industrisë së sigurimeve që të shqyrtoj mundësit që në një të ardhme të afert të bëjë limitin e epërm të caktimit të çmimit të policave të sigurimit e jo të jenë çmime standarde fikse.

Andaj rekomandohet që BQK-ja të shikoj mundësi e hapjes së më tutjeshme të tregut sipas praktikave me të mira. AKK do të reagoj në rastet, kur operatorët ekonomik në mënyrë të bashkërenduar veprojnë ndërmjet veti në formë të koordinuar (bashkëpunim jo formal), apo përmes marrëveshjeve të ndaluara-karteleve, duke eliminuar efektet e konkurrencës për konsumatorët.

Gjatë identifikimit të ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e sigurimeve jetë vërejmë se kemi dy kompani që zotërojnë tregun përkatës me një përqindje me mbi 90 % e që të dyja kanë pozite dominuese sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. AKK konstaton se ekziston konkurrencë jo e mjaftueshme në tregun e sigurimeve jetë,

Kërkohej nga rregullatori i tregut të sigurimeve të njoftoj Autoritetin e Konkurrencës për çdo rast të përqendrimeve në industrinë e sigurimeve bazuar në Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës në raste se:

- bashkimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura ose pjesëve të këtyre ndërmarrjeve;
- kontrolli i drejtperdrejt apo i terthoret ose ndikimin e pozitës dominuese të një apo me shumë ndërmarrjeve ose pjesëve të ndërmarrjeve,
- marrjen e shumicës së aksioneve ose një pjesë të tyre;

Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGUN E IMPORTIT TE NAFTES

Sektori i derivateve të naftës në Kosovë është i rregulluar me Ligjin Nr.2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës, qëllimi i të cilit është që të nxitet pjesëmarrja e konkurrencës së lirë dhe korrekte në sektorin e naftës në Kosovë; të sigurohet pagesa e të gjitha detyrimeve tatimore dhe fiskale mbi naftën dhe derivatet e naftës; të eliminohen sjelljet e paligjshme në sektorin e naftës; të ndihmojë në sigurimin e kualitetit, sigurisë, dhe sigurimin e furnizimit me derivateve të naftës.

Ligji për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës zbatohet ndaj të gjithë personave të angazhuar në shitjen me shumicë, shitjen me pakicë, transportin dhe deponimin e naftës dhe derivateve të saj në Kosovë.

Asnjë person nuk mund të merret me transport, deponim ose shitje të derivateve të naftës, brenda kapaciteteve të shitjes me shumicë dhe pakicë, për qëllime afariste, pa një licencë aktuale valide.

Tregu i produkteve të naftës në Kosovë është i liberalizuar, operatorët ekonomik janë plotësisht të lirë të përcaktojnë çmimet. Trendi i çmimeve të produkteve të naftës është i lidhur ngushtë me një numër parametrash kyçe që janë të njëjta për të gjithë operatorët ekonomik. Këto janë kryesisht çmimet e naftës së papërpunuar në tregun botëror dhe kursin e këmbimit të dollarit amerikan si monedhë kontabël. Të dy këto parametra kanë qenë shumë të paqëndrueshme gjatë viteve të fundit.

Sa i përket çmimeve të derivateve të naftës në tregun e Kosovës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, mund të reagojnë atëherë kur kemi të bëjmë me çmime të larta apo nën kosto (grabitqare) dhe atë në momentin kundër ndërmarrjeve të cilët në tregun përkatës janë në një pozitë dominuese.

Në mënyrë të ngjashme, AKK do të reagoj në rastet nëse, kur operatorët ekonomik në mënyrë të bashkërenduar veprojnë ndërmjet veti në formë të koordinuar (bashkëpunim jo formal), apo përmes marrëveshjeve të ndaluara-karteleve, duke eliminuar efektet e konkurrencës për konsumatorët (çmime më të ulëta, cilësi më të mirë, dhe mundësi zgjedhjesh).

Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës do të monitoron situatën në tregun e produkteve të naftës brenda kompetencave të tij dhe nëse gjen ndonjë parregullsi, do të reagoj sipas detyrës zyrtare.

Tregu i importit të naftës në Republikën e Kosovë ndahet 3 (tre) sektor:

- 1 Importi i naftës**
- 2. Shitja me shumice dhe pakice**
- 3. Përpunimi i produkteve të naftës**

1. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Importi i Naftës

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në Tregun e Importit të Naftës</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve të Importit të Naftës</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. "HIB PETROL" SH.P.K.	21.68%	Nuk ka PD

2.	"LAB - OIL " SH.P.K.	15.47%	Nuk ka PD
3.	"AL - PETROL" SH.P.K.	12.44%	Nuk ka PD
4.	"EX FIS" SH.P.K.	10.50%	Nuk ka PD
5.	"IP - KOS " SH.P.K.	5.81%	Nuk ka PD
6.	"PETROL COMPANY - SH.P.K.	4.11%	Nuk ka PD
7.	"N.T.SH. "PATRONI"	4.42%	Nuk ka PD
8.	"ALBAPETROL" SH.P.K.	4.45%	Nuk ka PD
9.	"ALFA TRADE" SH.P.K.	2.63%	Nuk ka PD
10.	"PETROL - OTI - SLOVENIJA L.L.C	2.26%	Nuk ka PD
11.	"KASTRATI" SH.P.K.	2.21%	Nuk ka PD
12.	"BENITA COMPANY.SH.P.K	1.89%	Nuk ka PD
13.	"HIT - PETROLL" SH.P.K.	1.58%	Nuk ka PD
14.	"N.P.T IBRAHIMI	1.35%	Nuk ka PD
15.	"N.P.T. "FAT OIL" SH.P.K.	1.27%	Nuk ka PD
16.	24 Operator Tjerë Ekonomik	7.94%	Nuk ka PD
	Gjithsej:	100 %	

2. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Shitja me shumice

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me shumice</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve Në tregun me shumice dhe pakice</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1.	"HIB PETROL"SH.P.K.	25.36%	Pozite dominuese
2.	" LAB-OIL " SH.P.K.	15.64%	Nuk ka PD
3.	" EX FIS " SH.P.K.	15.47%	Nuk ka PD
4.	"AL-PETROL" SH.P.K.	14.63%	Nuk ka PD
5.	„ ALBAPETROL " SH.P.K.	4.27%	Nuk ka PD
6.	N.T.SH.„PATRONI"	4.21%	Nuk ka PD
7.	„ALFA TRADE" SH.P.K.	3.96%	Nuk ka PD
8.	" KASTRATI " SH.P.K.	2.84%	Nuk ka PD
9.	N.P.T.„IBRAHIMI"	1.43%	Nuk ka PD
10	N.P.T." FAT OIL "SH.P.K	1.25%	Nuk ka PD
11	106 Operator Tjerë Ekonomik	37.48%	
	GJITHJSEJ:	100%	

3. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Shitja me pakice

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN ME PAKICË</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve Në TREGUN ME SHUMICE DHE PAKICE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1.	" IP - KOS " SH.P.K.	14.54%	Nuk ka PD
2.	"FAM -GAS"" L.L.C."	13.93%	Nuk ka PD
3.	"PETROL COMPANY -SH.P.K.	12.56%	Nuk ka PD
4.	"PETROL - OTI -SLOVENIJA L.L.C.	5.81%	Nuk ka PD
5.	" HIT-PETROLL " SH.P.K	4.26%	Nuk ka PD
6.	N.T. "STANDARD - BENZ " SH.P.K.	3.61%	Nuk ka PD
7.	N.T.P. " BALLKAN - PETROLL "	2.99%	Nuk ka PD
8.	N.T.P. " FLAMURI "	2.89%	Nuk ka PD
9.	N.T. "SPAHIA- PETROL"	1.92%	Nuk ka PD
10.	106 Operator Tjerë Ekonomik	37.49%	
	GJITHSEJ:	100%	

5. Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – Territori i Republikës së Kosovës
- Tregu i Produktit – Përpunimi i Produkteve të naftës

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e përpunimit të produkteve të naftës</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve E përpunimit të produkteve të naftës</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1.	"INN-OIL-RECYCLING"SH.P.K.	52.80%	Pozite dominuese
2.	"KOSOVA REFINERY SH.P.K.	47.20%	Pozite dominuese
	GJITHSEJ:	100%	

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës , rekomandon Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë për krijimin e një baze të të dhënave përmes të cilës do të bëjë grumbullimin e të dhënave nga subjektet afariste që mbajnë licencë për tregtimin dhe qarkullimin e derivateve të naftës në territorin e Republikës së Kosovës e cila do të jetë e disponueshme për institucionet përkatëse dhe rregullatoret e tregut.

Baza e formuar do të duhet të mundësojë monitorimin e të dhënave të mëposhtme:

- qarkullimi me shumicë i produkteve të naftës (në litra);
2. " Arena Sport " Sh.p.k.	15.68%	NUK KA PD
3. " EGTK II " SH.P.K.	10.04%	NUK KA PD
4. N.T.SH. " GAME PLUS "	8.55%	NUK KA PD
5. Co-Colina Sh.p.k.	8.04%	NUK KA PD
6. N.SH.H. " PLANET WIN 365 "	7.92%	NUK KA PD
7. N.SH. LOTARIA E KOSOVËS	6.23%	NUK KA PD
8. " EUROLLOTO " SH.P.K.	5.26%	NUK KA PD
9. " MARKET PLUS 1 " SH.P.K.	3.46%	NUK KA PD
10. N.SH. "Toto Sport"	3.15%	NUK KA PD
11. "EURO GAME " SH.P.K.	3.01%	NUK KA PD
12. KOM. E LOJ. TË FATIT "ARTI SPORTIV " SH.P.K.	2.51%	NUK KA PD
13. " LOTTO SPORT " SH.A.-DEGA NË KOSOVË	2.50%	NUK KA PD

Rekomandimet dhe mendimet profesional

Tregu i lojrave të fatit, Autoriteti konsideron se ky treg është i liberalizuar, konkurrues dhe struktura e tregut të ndërmarrjeve është shumë mirë e organizuar sa i përket shtrirjes, përqendrimit dhe konkurrueshmerisë.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg.

Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGUN I MEDIAVE DHE PRODUKSIONEVE KINEMATOGRAFIKE

Në kuader të hulumtimit të **Tregut të Mediave dhe Produksioneve Kinematografike**, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka zhvilluar takime me rregullatorin përkate. Kemi siguruar informacione se tregu i mediave dhe produksioneve kinematografike në Kosovë ndahet në 6 (gjashtë) lloje të mediave dhe Produksioneve kinematografike.

Tregu i mediave dhe produksioneve kinematografike
--

1. Televizion dhe Radio
2. Gazetat dhe portalet
a. Web Portalet dhe publikimi i gazetave
b. Printimi i gazetave
3. Krijimtaria artistike
4. Kinematografia
a. Prodhimi i filmave, video dhe programeve televizive
b. Aktiviteti i Post produksioneve të filmave, video dhe programeve televizive
c. Shpërndarja e filmave, video dhe programeve televizive
d. Projektimi i filmit
5. Inçizimi i zërit dhe publikimi i muzikës

LICENCIMI I SHËRBYESVE MEDIAL AUDIOVIZUELE

Për të ushtruar veprimtarinë në fushën e shërbimeve mediale audio-vizuale në Republikën e Kosovës sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM).

Subjektet e licencuara duhet të veprojnë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, si dhe me të gjitha aktet nënligjore siç janë të përcaktuara nga KPM-ja.

Sipas planit të frekuencave të transmetimit të disponueshëm për Republikën e Kosovës, KPM ndanë frekuenca të mjaftueshme për Transmetuesin Publik për t'i mundësuar që t'i ofrojë popullsisë së Kosovës një mbulim radio televiziv deri në masën maksimale të mundshme.

Autoriteti me qëllim të hulumtimit sa më të saktë të tregut përkatës ka realizuar edhe një pyetesor për KPM-në, si rregullator dhe licencues i operatorëve në tregun përkatës, në territorin e Republikës së Kosovës.

Në tregun medial në Kosovë operojnë: Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale (radiot dhe televizionet me frekuencë nacionale regjionale dhe lokale, televizionet pa frekuencë pra përmes operatorëve të shpërndarjes dhe Operatorët e Shpërndarjes (Kabllor dhe IPTV).

Struktura e mediave në Kosovë është kjo: 20 TV stacione me frekuencë (3 nacional, 12 regjional, 5 lokal) 83 Radio stacione (4 nacionale, 15 regjionale, 61 lokale, 3 me fuqi të ulët), 48 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA pa frekuencë, transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes) dhe 40 operatorë të shpërndarjes (operator kabllor dhe 4 IPTV). Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet me sinjal televiziv nacional vetëm me 62,7%. Ndërsa me sinjal radio mbulohet me mbi 90%.

Bazuar në te dhenat që ka siguruar Autoriteti nga rregullatori për media KPM dhe ATK, analizimi dhe vlerësimi në detaje i tyre, gjejmë se në territorin e Republikës së Kosovës, tregu i mediave është i rregulluar, i liberalizuar dhe konkurrues.

Gjatë hulumtimit të tregut dhe analizimit të tij vërejmë se vetëm transmetuesi publik RTK, i cili e ka statusin e rregulluar me ligj të veçantë, por në raport me Ligjin e KPM-së edhe ky transmetues trajtohet në mënyrë të barabartë me mediat tjera private që veprojnë në tregun përkatës.

Tregu i gazetave dhe portaleve, autoriteti konsideron se ky treg shtrihet në 2 fusha: 1. Webportalet dhe Publikimi i Gazetave dhe 2. Printimi i gazetave.

Në ditët e sotme, industria e gazetave dhe medias po zhvillohet në mënyrën e prezantimit në internet. Njerëzit janë gjithmonë të lidhur në internet për të qëndruar me të informuar me atë qëfar po ndodh në mbarë botën, për arsye të jetes dinamike në botën e sotme, portalet janë venë në funksion dhe zejnë një vend të konsiderueshem të lexuesi i sotem.

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **TREGU I MEDIAVE – TELEVISIONET DHE RADIO**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e MEDIAVE - TELEVISIONET</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve MEDIAVE - TELEVISIONET</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. "COMPANY 21" SH.P.K.	26.81%	KA PD
2. " Grupi Koha " Sh.p.k.	22.93%	NUK KA PD
3. "KLAN KOSOVA " SH.P.K.	14.94%	NUK KA PD
4. RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS RTK	14.69%	NUK KA PD
5. Radio Televizioni " Dukagjini " Sh.p.k.	5.21%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **TREGU I MEDIAVE – WEB PORTAL DHE PUBLIKIMI I GAZETAVE**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN WEB PORTALEVE DHE PUBLIKIM TE GAZETAVE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve WEB PORTALEVE DHE PUBLIKIM TE GAZETAVE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. N.B. " Media Works " Sh.p.k.	26.28%	KA PD
2. NGB " KOSOVA SOT " SH.P.K.	14.53%	NUK KA PD
3. NGB " Zëri " SH.P.K.	12.59%	NUK KA PD
4. " Tribuna Media Group " SH.P.K.	9.98%	NUK KA PD
5. " AVAMO " L.L.C.	9.97%	NUK KA PD
6. "JAVA MULTIMEDIA PRODUCTION"SH.P.K.	6.64%	NUK KA PD
7. N.SH. " TECH VISION "	6.40%	NUK KA PD
8. „Epoka e Re"	5.43%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **TREGU I MEDIAVE – PRINTIMI I GAZETAVE**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN E PRINTIMIT TE GAZETAVE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve PRINTIMI I GAZETAVE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. " Roto Print " Sh.p.k.	55.38%	KA PD
2. N.B.T. " Siprint " Sh.p.k.	17.58%	NUK KA PD
3. N.G. RILINDJA	9.42%	NUK KA PD
4. N.SH.G. " X print "	5.01%	NUK KA PD
5. " PROJECTGRAPHICS " SH.P.K.	3.64%	NUK KA PD
6. N.SH.T. " DDPRINT "	2.75%	NUK KA PD
7. N.P.T. SHTYPSHKRONJA " ERA "	2.23%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **TREGU I MEDIAVE – KRIJIMTARIA ARTISTIKE**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN E KRIJIMTARISE ARTISTIKE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve KRIJIMTARIA ARTISTIKE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. N.SH.H. ARTIST ESTRAD E 'XENI'	30.23%	KA PD
2. N.SH."B.DINA-OXYGEN"	10.74%	NUK KA PD
3. " BUKA " SH.P.K.	8.25%	NUK KA PD
4. N.T.SH. " TICK MEDIA "	3.73%	NUK KA PD
5. " MONEYZ " SH.P.K.	3.46%	NUK KA PD
6. N.I. PETRIT HALILAJ	2.92%	NUK KA PD
7. N.SH. " STUDIO BY HEKI "	2.72%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **KINEMATOGRAFIA**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN E KINEMATOGRAFIA</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve KINEMATOGRAFIA</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. " OnAir Media " SH.P.K.	21.78%	NUK KA PD
2. N.SH. " KOPERATIVA COMMUNICATIONS"	10.20%	NUK KA PD
3. SOLIDAR SUISSE SCHWEIZERISCHES ARBEITERPILFSWERK	8.20%	NUK KA PD
4. K.D.SH.F. "GENCI"	6.74%	NUK KA PD
5. " PULLA " SH.P.K.	6.30%	NUK KA PD
6. " SKY MEDIA " SH.P.K.	5.81%	NUK KA PD
7. " ALBUNION-MEDIA " SH.P.K.	5.20%	NUK KA PD
8. " IKONË- STUDIO " SH.P.K.	4.31%	NUK KA PD
9. N.T.SH. " Almiri - AS " Sh.p.k.	2.51%	NUK KA PD
10. N.SH." BEZE "	2.43%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **INCIZIMI I ZËRIT DHE TE TJERA**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN E INCIZIMIT TE ZERIT</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve INCIZIMI I ZERIT</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. N.F.M., „Eurolinde“	59.96%	KA PD
2. " BM 654 " SH.P.K.	8.10%	NUK KA PD
3. N.SH. " HYXHYM "	6.17%	NUK KA PD
4. " REDBOX " SH.P.K.	5.47%	NUK KA PD
5. " V & L " SH.P.K.	4.49%	NUK KA PD
6. N.P.T. " Kola - Commerc "	3.77%	NUK KA PD

Rekomandimet dhe mendimet profesional

Tregu i Televizioneve dhe Radiove - Autoriteti Kosovar i konkurrencës vlereson se është e rëndësishme të theksoj se legjislacioni i cili rregullon kete treg është i hartuar në frymen e konkurrencës, gjithashtu tregu përkatës është i liberalizuar.

Tregu gjeografik është territori i Republikës së Kosovës dhe struktura e tyre në përqindje (shih. tabelën) ku gjejme se Compania 21 –sh.p.k, mban pozitën dominuese me 26.81% të tregut, në raport me transmetuesit-operatorët tjerë, të cilët veprojnë në tregun përkatës.

Pasi që Ligji Nr. 04/L-44 për KPM, Neni 9 - Politika e transmetimit, Pika 6 përcakton së “Politika e transmetimit, do të promovojë zbatimin e dispozitave të cilat parandalojnë monopolizimin e transmetimit në Kosovë duke promovuar konkurrencë të drejtë për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale”.

Keshtu që për tregun e Televizioneve dhe Radiove, Autoriteti nuk ka ndonjë rekomandim, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës.

Tregu i gazetave dhe webportaleve - Gjate hulumtimit të tregut, Autoriteti vëren se ky treg është i liberalizuar dhe konkurrues. Nga rezultatet statistikore për strukturën e tregut, gjejme se ndermarrja N.B. Media Works sh.p.k mbanë pozite dominuese në përqindje prej 26.28%.

Autoriteti nuk ka ndonjë rekomandim për këtë treg, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës.

Tregu i printimit të gazetave, Autoriteti Konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurrues, por gjate analizimit dhe vleresimit të të dhenave marr nga rregullatorët tjerë, vërejmë se ndermarrja Roto Print Sh.p.K mbanë pozitën të ndjeshme dominuese në përqindje prej 55.38%.

Autoriteti nuk ka ndonjë rekomandim për këtë treg, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës.

Tregu i krijimtarisë artistike, Autoriteti Konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurrues në tërë Republikën e Kosovës por vërejmë se ndermarrja N.SH.H. ARTIST ESTRADÉ 'XENI' mbanë pozitën dominuese në përcindje prej 30.23%.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës.

Tregu i kinematografise, Autoriteti konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurruese dhe struktura e tregut te ndërmarrjeve është shume mire organizuar sa i përket shtrirjes,përqendrimit dhe konkurrueshmerisë.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg.

Tregu i inqizimit te zerit dhe publikimi i muzikes, Autoriteti Konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurruese në tërë Republikën e Kosoves por verejme se ndermarrja *Eurolindi sh.p.k* mbanë pozitën dominuese në përcindje prej 59.96%.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës.

Hulumtimi i bërë nga
 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGUN FINACIAR DHE BANKAR

Në kuader të tregut financiar dhe bankar ky hulumtim synon të analizojë sistemin bankar në Kosovë, duke përcaktuar dhe më pas analizuar: strukturën e tij, shkallën e përqendrimit të bankave komerciale në tregun bankar dhe numri i pjesëmarrësve /bankat që operojnë në këtë treg. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës konsideron se në tregun Financiar dhe Bankar kemi 3 lloje të shërbimeve financiare në nivel të vendit. Ato ndahen në Banka Komerciale, Institucione Microfinanciare dhe Institucionet Financiare Jo bankare.

Pavarësisht kompleksitet të këtij tregu, jemi përpjekur që ky hulumtim të mos jetë vetëm informues, por të analizojë dhe përcaktoj poziten dominuese apo Monopolistike të ndërmarrjeve që operojnë në tregun relevant, tendencat dhe zhvillimet e tij, dhe ndjeshmeria e konkurrencës efektive duke identifikuar strukturën reale të tregut.

Tregu i FINANCIAR DHE BANKAR ndahet në
<ol style="list-style-type: none"> 1. Banka 2. IMF (Institucione Microfinanciare) 3. IFJB (Institucione Financiare jo Bankare)

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **REPUBLIKA E KOSOVËS**
- Tregu i Produktit – **BANKA DHE SHËRBIME**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në TREGUN BANKAVE DHE SHËRBIMEVE</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve BANKAVE DHE SHËRBIMEVE</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.	25.49%	Ka PD
2. "PROCREDIT BANK" SH.A	19.90%	NUK KA PD
3. TEB SH A	17.56%	NUK KA PD
4. " NLB Banka " SH.A.	14.09%	NUK KA PD
5. Banka Kombëtare Tregtare - Dega në Kosovë	7.48%	NUK KA PD
6. Banka Ekonomike Sh.a	6.84%	NUK KA PD
7. " Banka për Biznes " Sh.a.	6.77%	NUK KA PD
8. " TURKIYE IS BANKASI A.S. " DEGA NË KOSOVË	1.73%	NUK KA PD
9. "TURKIYE CUMHURIYETI ZIRAAT BANKASI A.S" - DEGA NË KOSOVË	0.14%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – REPUBLIKA E KOSOVËS
- Tregu i Produktit – SHËRBIMET INSTITUCIONEVE MICROFINANCIARE

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SHËRBIMET E IMF</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SHËRBIMET E IMF</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1.	Timi Invest	1.79%	NUK KA PD
2.	START	2.06%	NUK KA PD
3.	Perspektiva 4	0.10%	NUK KA PD
4.	Kreditimi Rural i Kosoves	15.32%	NUK KA PD
5.	KosInvest	1.62%	NUK KA PD
6.	KGMAMF	4.40%	NUK KA PD
7.	KEP Trust	19.72%	NUK KA PD
8.	FINCA	18.72%	NUK KA PD
9.	Qelim Kosovë	0.40%	NUK KA PD
10.	Atlantic Capital Partners	0.19%	NUK KA PD
11.	Agjencioni për Financim në Kosovë	13.13%	NUK KA PD
12.	Factor Leasing	0.12%	NUK KA PD
13.	LESNA	2.52%	NUK KA PD
14.	Crimson Finance Fund	3.37%	NUK KA PD
15.	Raiffeisen Leasing Kosovo	16.53%	NUK KA PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – REPUBLIKA E KOSOVËS
- Tregu i Produktit – SHËRBIMET E IFJB (INSTITUCIONE FINANCIARE JO BANKARE)

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun SHËRBIMET E IFJB-ve</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve SHËRBIMET E IFJB-ve</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1.	Unioni Financiar Prishtinë Sh.p.k.	40.94%	KA PD
2.	"MONETA SH.P.K.	24.75%	NUK KA PD
3.	IFJB " CAPITAL " SH.P.K.	11.84%	NUK KA PD
4.	N.SH.P."VLLESA-CO"SH.P.K	11.17%	NUK KA PD
5.	" INSTITUCIONI FINANCIAR JO BANKAR " LESNA " SH.A.	9.01%	NUK KA PD
6.	"AGC FAKTOR"L.L.C.	2.16%	NUK KA PD
7.	" PRO PAID " SH.P.K.	0.13%	NUK KA PD

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Tregu i bankave, Autoriteti Konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurruese në tërë Republikën e Kosovës por vërejmë se banka *Raiffaizen Bank J.S.C.* mbanë pozitën dominuese në përqindje prej 25.49%. Megjithatë, duhet të theksohet se rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla ka ndikuar që shkalla e koncentrimit në tregun bankar të shënojë rënie të vazhdueshme që nga viti paraprak.

Mendim Profesional - Sistemi bankar në Kosovë ka një rënie të koncentrimit të tregut, ku rreth 62.95% përqind e strukturës së tregut e mbajnë 3 (tri) bankat kryesore (*Raiffaizen Bank*, *Procredit Bank* dhe *TEB bank*). Dy bankat më të mëdha *Raiffaizen bank* dhe *ProCredit Bank* kanë pjesëmarrje në strukturën e tregut prej 45.85%. Dy ose me shume ndërmarrje te pavarura mund te jenë në pozite dominuese nëse në raport me konkurrentet e tyre veprojnë bashkarisht në tregun relevant, si dhe pjesëmarrja e përgjithshme e tyre në treg është me e larte se 40% (pozita dominuese kolektive).

Andaj, theksojme se barra e konstatimit qe pozitën dominuese në treg mund ta kete edhe pjesëmarrsi, pjesa e te cilet në tregut relevant është me e ulet se (25%), respektivisht në raste te dominimit kolektiv, me e ulet se (40%), bie mbi Autoritetin.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës.

Tregu i Institucioneve Mikrofinanciare, Autoriteti konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurruese dhe struktura e tregut te ndërmarrjeve është shume mire organizuar sa i përket shtrirjes,përqendrimit dhe konkurrueshmerisë.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg.

Tregu i Institucioneve Financiare Jo Bankare - Autoriteti Konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurruese në tërë Republikën e Kosovës por vërejmë se *IFJB Unioni Financiar Prishtinë sh.p.k.* mbanë pozitën dominuese në përqindje prej 40.94%.

Autoritei nuk ka ndonje rekomandim për këtë treg, por do t'i monitoroj të gjitha ndërmarrjet që mbajnë pozitë dominuese në tregun përkatës

Hulumtim i bërë nga
 Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGU I MINIERAVE DHE MINERALEVE

Në kuadër të këtij hulumtimi për tregun e Minierave dhe Mineraleve, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka zhvilluar takime me rregullatorin e kësaj fushe siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM). Ky treg rregullohet me Ligjin për Miniera dhe Minerale Nr. 03/L-163 si dhe Ligji Nr. 04/L-158 për ndryshimin dhe plotësimin e tij, i cili zbatohet për të gjitha aktivitetet në këtë sektor që përfshijnë: Shfrytëzimin, hulumtimin dhe aktivitetet e veçanta.

Sektori minierar është njëri ndër sektorët më kryesor për zhvillimin ekonomik të vendit, mirëpo ky sektor ende nuk ka arritur që të ketë efekt të ndjeshëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Zhvillim i qëndrueshëm i këtij sektori mund të arrihet duke u bazuar në resurset që ka Kosova dhe duke u mbështetur në praktikat më të mira të vendeve që e kanë të zhvilluar këtë sektor.

Tregu i minierave dhe mineraleve, bazuar në ligjin për miniera dhe minerale ndahet në 3 lloje të aktiviteteve:

9. Shfrytëzimi
10. Hulumtimi
11. Aktivitetet e veçanta

Tregu i minierave dhe mineraleve përkatësisht sektori i Shfrytëzimit nënkupton aktivitetin i cili zbatohet për zonën që nevojitet për shfrytëzimin e resursit përkatës Mineral.

Tregu i minierave dhe mineraleve përkatësisht sektori i Hulumtimit nënkupton aktivitetet që përfshijnë hartografinë gjeologjike, marrjen e mostrave të dheut dhe shkëmbit, hapjen e transheve, shpimet, matjet gjeo-fizike dhe aktivitetet e ngjashme që ndërmerren për qëllime të hulumtimit ose qëllime tjera.

Tregu i minierave dhe mineraleve përkatësisht sektori i Aktivitete të veçanta nënkupton: aktivitetet e hulumtimit që përfshijnë: shpimin, gërmimin, marrjen e mostrave, matjet gjeofizike, operimin e makinerisë ose pajisjeve, dhe aktivitetet e ndërlidhura që ushtrohen më qëllim të hulumtimit dhe që fizikisht e ndryshojnë ose çrregullojnë sipërfaqen e tokës, shfrytëzimin e eksplozivëve për qëllime të shfrytëzimit ose hulumtimit të mineraleve, shfrytëzimit zejtar, aktivitetet tjera minerale që janë të përcaktuara nga KPMM.

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **territori i Republikës së Kosovës**
- Tregu i Produktit – **sektori i Shfrytëzimit**

	<i>Ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e sektorit të Shfrytëzimit</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në tregun e sektorit të Shfrytëzimit</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1.	Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a.	42.96%	Ka Pozitë Dominuese
2.	"SharrCem" sh.p.k.	10.17%	Nuk ka PD
3.	Newco Ferronikeli Complex LL.C.	6.96%	Nuk ka PD
4.	"Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP"	5.90%	Nuk ka PD
5.	"Benita Company" Sh.p.k.	3.45%	Nuk ka PD
6.	N.T.SH. "Dino" Sh.p.k.	2.46%	Nuk ka PD
7.	"Eskavatori" Sh.p.k.	2.12%	Nuk ka PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **territori i Republikës së Kosovës**
- Tregu i Produktit – **sektori i Hulumtimit**

<i>Ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e sektorit të Hulumtimit</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në tregun e sektorit të Hulumtimit</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1.	"Conex Group" SH.P.K	37.532%	Ka Pozitë Dominuese
2.	"Soal" sh.p.k. - Dega në Kosovë	9.090%	Nuk ka PD
3.	"Shkembali " Sh.p.k	8.120%	Nuk ka PD
4.	"Fidani- Beton" sh.p.k.	7.372%	Nuk ka PD
5.	"Agi - Dani" sh.p.k.	6.702%	Nuk ka PD
6.	"DE-KO" SH.P.K.	5.673%	Nuk ka PD
7.	"Çeta -General Invest Group"sh.p.k	5.488%	Nuk ka PD
8.	"SKP" sh.p.k.	3.747%	Nuk ka PD
9.	"Kushtrimi NM" Sh.P.K	3.168%	Nuk ka PD
10.	"EUROKOFIX GmbH" Sh.p.k.	2.539%	Nuk ka PD

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **territori i Republikës së Kosovës**
- Tregu i Produktit – **sektori i Aktivitetet e veçanta**

<i>Ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e sektorin e Aktivitetet të veçanta</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në tregun e sektorin e Aktivitetet të veçanta</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1.	"Fitorja" Sh.p. k.	20.05%	Nuk ka PD
2.	N.N. "R & Rukolli" Sh.p.k	8.19%	Nuk ka PD
3.	"Jaha Company" Sh.p.k.	6.98%	Nuk ka PD
4.	K.N.P.SH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k.	5.52%	Nuk ka PD
5.	"Ndërtimtari" SH.P.K	5.15%	Nuk ka PD
6.	"Toni Compani" sh.p.k.	4.97%	Nuk ka PD
7.	N.N.T.SH. "Drini Company" Sh.p.k.	4.64%	Nuk ka PD
8.	KOSOVA THËNGJILLI - SH.A	4.55%	Nuk ka PD
9.	"Jehona" Sh.p.k.	3.33%	Nuk ka PD
10.	"Arbëria Turist " Sh.p.k.	3.15%	Nuk ka PD
11.	"Eti" Sh.p.k.	2.70%	Nuk ka PD
12.	N.P.N "Albing" Sh.p.k	2.50%	Nuk ka PD
13.	"Titan Beton" S h.p.k.	2.47%	Nuk ka PD
14.	"Unioni" Sh.p.k.	2.27%	Nuk ka PD
15.	"ALBIONI" SH.P.K.	2.03%	Nuk ka PD
16.	"BENI - COM" Sh.P.K.	2.00%	Nuk ka PD

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Në bazë të të gjeturave nga analiza e Autoritetit del se tregu i minierave dhe mineraleve përkatësisht në sektorin e Shfrytëzimit operojnë 180 ndërmarrje të cilat janë të licencuara nga organi rregullativ. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurrent. Ligji përkatës që e rregullon këtë sektor nuk e kufizon asnjë ndërmarrje të re që të futet në treg, por gjatë analizimit dhe hulumtimit përkatës, rezultatet statistikore tregojnë se ndërmarrja *Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.* mbanë pozitë dominuese në tregun përkatës me 42.96%.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk ka ndonjë rekomandim specifik rreth Liberalizimit të tregut dhe konkurrueshmërisë, por nënvizon se ndërmarrja me pozitë dominuese në tregun përkatës mund të abuzojë me pozitën e saj. Andaj për parandalimin e kësaj dukurie Autoriteti do të jetë në monitorim dhe koordinim të vazhdueshëm me rregullatorin përkatës.

Në bazë të të gjeturave nga Autoriteti del se e tregu i minierave dhe mineraleve përkatësisht në sektorin e Hulumtimit operojnë 165 ndërmarrje të cilat janë të licencuara nga organi rregullativ. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurrent. Ligji përkatës nuk kufizon asnjë ndërmarrje të re që të futet në treg, por gjatë analizimit dhe hulumtimit përkatës, rezultatet statistikore tregojnë se ndërmarrja *"Conex Group" Sh.p.k* mbanë pozitë dominuese në këtë treg.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk ka ndonjë rekomandim specifik rreth liberalizimit të tregut dhe konkurrueshmërisë, por nënvizon se ndërmarrje me pozitë dominuese mund të abuzojë me pozitën apo fuqinë e saj në tregun përkatës. Andaj për parandalimin e kësaj dukurie Autoriteti do të jetë në monitorim dhe koordinim të vazhdueshëm me rregullatorin përkatës.

Në bazë të të gjeturave nga Autoriteti del se tregu i minierave dhe mineraleve përkatësisht në sektorin e Aktiviteteve të veçanta operojnë 165 ndërmarrje të cilat janë të licencuara nga organi rregullativ. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës konsideron se ky treg është i liberalizuar dhe konkurrent. Ligji përkatës nuk e kufizon asnjë ndërmarrje të re që të futet në treg. Konsiderojmë se në sektorin për aktivitete të veçanta, asnjë ndërmarrje nuk mbanë pozitë dominuese andaj struktura e tregut dhe përqendrimi i tyre është mjaft konkurrues.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës nuk ka ndonjë rekomandim specifik rreth Liberalizimit të Tregut dhe konkurrueshmërisë në sektorin e Aktiviteteve të veçanta.

Vërejtje:

Shumica e operatorëve të cilët operojnë në tregun përkatës të Minierave dhe Mineraleve kanë licenca dhe zhvillojnë aktivitete për të tri veprimtaritë (Shfrytëzim, Hulumtim & Aktivitete të veçanta). Autoriteti ka siguruar të dhëna nga rregullatorët përkatës dhe nga ATK-ja për qarkullim vjetor të operatorëve përkatës. Metodologjia e nxjerrjes së strukturës e tregut për këtë sektor është bazuar në qarkullimin vjetor të operatorëve. Gjatë hulumtimit të hollësishëm kemi vërejtur se është e pamundur të ndahet qarkullimi vjetor i ndërmarrjeve për secilin veprimtari veç e veç. Andaj mund të ekziston një përqindje e ultë e diskrepancës në ofrimin e të dhënave të paraqitura më lartë.

*Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për*
TREGU I PAJISJEVE FISKALE

Grupi punues gjatë hulumtimit të këtij tregu ka konstatuar se tregun e pajisjeve fiskale e rregullon, përcjell dhe licencën operatorët ekonomik Divizioni për arka fiskale, i cili funksionon në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Licencimi i operatorëve ekonomik për arka fiskale bëhet nga ky Divizion. Ky treg rregullohet sipas Udhëzimit Administrativ 01/2015 për PEF (Pajisjet Elektronike Fiskale) dhe DOKUMENTI “pajisjet elektronike fiskale, kërkesat dhe karakteristikat funksionale dhe teknike”. Sipas këtij Udhëzimi Administrativ nuk ka kufizime ligjore në aspektin e liberalizimit të tij sepse çdo prodhuese, importuese ose montues i PEF-it mund të bëhet operator i autorizuar i PEF, për një apo më shumë modele specifike në çdo kohë sipas kriterëve të publikuara nga njësia për menaxhimin e arkave fiskale (NjMAF).

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në vitin 2010 ka ndërhyrë në këtë treg duke zhvilluar hetime dhe ka rezultuar me shqiptimin me sanksione administrative në vlerë prej nga 100.000,00 euro për dy operatorë të cilët ka konstatuar sjelljet e tyre anti-konkurrese në shkelle esenciale të dispozitave ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Vendimi i Autoritetit ka ndikuar tek organi mbikëqyrës që të bëhet liberalizimi i këtij tregu.

Deri në fund të vitit 2016 ATK-ja ka autorizuar gjithsej 7 operator ekonomik që ushtrojnë këtë veprimtari ekonomike. Të gjithë këta operator ekonomik përveç që merren me tregtimin me pajisje fiskale ofrojnë edhe instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike fiskale. Këto ndërmarrje janë aktive dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik.

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik – **territori i Republikës së Kosovës**
- Tregu i Produktit – **pajisjet elektronike fiskale – PEF**

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e PEF</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në tregun e PEF</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. "GEKOS" Sh.p.k	58.28%	Ka Pozitë Dominuese
2. "Dukagjini" Sh.p.k	25.84%	Ka Pozitë Dominuese
3. "PRINTEC " L.L.C.	8.08%	Nuk ka PD
4. N.T.SH. " Enternet "	5.85%	Nuk ka PD
5. "BBROS " L.L.C	1.39%	Nuk ka PD
6. "SERVICE GLOBAL EU " SH.P.K.	0.49%	Nuk ka PD
7. N.T."GLOBAL TRADE"	0.07%	Nuk ka PD

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Në bazë të të gjeturave nga Autoriteti del se tregu i pajisjeve fiskale është i liberalizuar dhe konkurrent. Legjislacioni përkatës nuk e kufizon asnjë ndërmarrje të re që të futet në treg, por gjatë analizimit dhe hulumtimit përkatës, rezultatet statistikore tregojnë se ndërmarrjet "GEKOS" Sh.p.k. (58.28%) dhe "Dukagjini" Sh.p.k. (25.84%) mbajnë pozita dominuese në këtë treg në përqindje të përbashkët rreth 84% e tregut.

Ky treg është i rregulluar me ligj dhe akte tjera nënligjore, andaj si i tillë është i liberalizuar dhe ekziston një konkurrueshmëri e mjaftueshme, andaj Autoriteti nuk ka ndonjë rekomandim specifik për institucionet që e rregullojnë këtë treg, por nënvizon se ndërmarrjet të cilat janë në pozitë dominuese mund të abuzojnë me pozitën apo fuqinë e tyre në treg. Andaj për parandalimin e kësaj dukurie Autoriteti do të jetë në monitorim dhe koordinim të vazhdueshëm me rregullatorin përkatës.

Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGU I FURNIZIMIT ME UJË

Në kuadër të hulumtimit të tregut me furnizim me ujë, Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar takime me rregullatorët përkatës dhe ka siguruar informacione se tregu relevant ndahet në 3 lloje të sektorëve.

Sektori për:

1. Furnizimi me ujë të pijshëm (ujësjellës)
2. Furnizimi me ujë për ujitje dhe
3. Prodhimi i ujit të ambalazhuar dhe pijeve freskuese.

Tregu i furnizimit me ujë është i rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujëra dhe Ligji nr. 05/L-042 që trajton licencimin, tarifat e shërbimit, standardet e shërbimit monitorimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Rregullatori kryesor mbi monitorimin dhe menaxhimin e furnizimit me ujë është Autoriteti Rregullativ i Ujërave, i cili është në zbatimin e dy ligjeve të lartpërmendura.

Meqenëse resurset ujore të Kosovës janë pasuri shtetërore, andaj edhe tregu i furnizimit me ujë të pijes, përmes ujësjellësit ka karakterin e monopolit natyrorë. Në këtë treg operojnë 7 ndërmarrje publike regjionale të ujit (KUR), pronar gjegjësisht aksionar të këtyre ndërmarrjeve është Qeveria e Republikës së Kosovës me 100% të aksioneve. Me ofrimin e shërbimeve dhe produktit, këto ndërmarrje mbulojnë rreth 90% të vendbanimeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndërmarrjet përkatëse përveç ofrimit të furnizimit me ujë të pijes, ato ofrojnë edhe shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Gjithashtu vërejmë se përcaktimi i çmimit të ujit për metër kub është i përcaktuar ekskluzivisht nga ARRU-ja bazuar në kriteret e përcaktuara me Rregulloren për Tarifat. Vlen të theksohet se asnjë ndërmarrje regjionale nuk i ka çmimet e njëjta për këto shërbime.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës konsideron se ky treg nuk ka mundësi fizike dhe teknike të liberalizohet. Arsyeja e mos liberalizimit të këtij tregu është sepse asnjë ndërmarrje private nuk ka kapacitete infrastrukturore të ofrojë këtë shërbim.

Tregu i furnizimit me ujë për ujitje në Republikën e Kosovës është i rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujëra, këtë treg e mbikëqyrë dhe rregullon, Autoriteti Rregullativ i Ujërave (ARRU). Bazuar në informatat e siguruar nga ARRU, në këtë treg operojnë 3 ndërmarrje publike pronar/aksionar i të cilave është Qeveria e Republikës së Kosovës përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Meqenëse resurset ujore të Kosovës janë pasuri shtetërore, andaj edhe tregu i furnizimit me ujë për ujitje, ka karakterin e monopolit natyrorë. Në këtë treg operojnë 2 ndërmarrje publike Regjionale dhe ndërmarrja publike **Ibër Lepenci** e cila tejkalon përmasat e regjionit. Ndërmarrja **Ibër Lepenci** ushtron këto veprimtari: Furnizimin me ujë të papërpunuar, të akumuluar në liqenin e Ujëmanit për:

1. Për industri (TREPÇËN, KEK-un dhe FERONIKEL-in)
2. Për Ujësjiellësin Rajonal Prishtina dhe Mitrovica
3. Bujqësi (mirëmbajtjen dhe furnizimin e rrjetit për ujitje deri në hidrant)

Tregu i prodhimit të ujit të ambalazhuar dhe pijeve freskuese në Republikën e Kosovës është treg i cili dominohet nga ndërmarrjet private. Bazuar në hulumtimin e bërë nga Autoriteti, vërejmë se asnjë ndërmarrje publike nuk ushtron veprimtari ekonomike në këtë sektor. Ndërmarrjet nuk kanë asnjë kufizim ligjor që të futen në këtë treg. Në këtë treg zhvillimi i ndërmarrjes bazohet në ofrimin e produkteve cilësore, shërbimeve më të mira dhe inovacionet. Në këtë treg operojnë afërsisht 150 ndërmarrje të ndryshme të

cilat ushtrojnë veprimtarin ekonomike në të njëjtën sektor të tregut. Autoriteti konsideron që tregu përkatës është i liberalizuar me një presion të mjaftueshëm konkurruese i cili presion operatorët ekonomik i shpie në rritjen e cilësisë, çmime më të favorshme dhe krijimin e produkteve inovative.

Tregu Relevant:

- Tregu Gjeografik
 - o Regjioni i PRISHTINËS
 - o Regjioni i PRIZRENIT
 - o Regjioni i MITROVICËS
 - o Regjioni i PEJËS
 - o Regjioni i GJAKOVËS
 - o Regjioni i FERIZAJT
 - o Regjioni i GJILANIT
 - o ZUBIN POTOK
 - o LEPOSAVIÇ

- Tregu i Produktit – Uji i pijshëm (UJËSJELLËSI)

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KUR "PRISHTINA" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KUR "HIDRO-REGJIONI JUGORË" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KUR "MITROVICA" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KRU "HIDRO-DRINI" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KRU "RADONIQI" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KUR "BIFURKACIONI" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. KUR "HIDRO-MORAVA" SH.A.	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1.	Kompania e ujësjellësit dhe mbeturinave "IBRI" Zubin Potok SH.A	100%	Monopol
<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim për ujë të pijshëm</i>		<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim për ujë të pijshëm</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1.	Kompania e ujësjellësit dhe mbeturinave "24 Nëntori" SH.A. Leposaviç	100%	Monopol

1. JKP '24 Novembar' Leposaviç

- ka pasur licencë për shërbime të ujit dhe për ujëra të zeza nr. SL/204/05 nga 01.11.2005 gjer më 30.04.2006;
- ka pasur licencë shërbimi për grumbullimin e mbeturinave nr. SL/325 nga 30.11.2005 gjer më 30.05.2006;

me Vendim të Rregullatorit nr. 323/SL dhe nr. 325/SL te dt. 08.06.2006 i është përtëri licenca e shërbimit për të dy shërbimet gjer më 31.12.2006.

2. JKSP "Zveqan" Zveqan

- ka pasur licencë shërbimi nr. 204/SL/05 për grumbullimin e mbeturinave nga 30.11.2005 gjer më 30.05.2006, me Vendim të Rregullatorit nr. 326/SL i dt. 08.06.2006 i është përtëri licenca e shërbimit gjer më 31.12.2006.

3. JPKD "Ibar" Zubin Potok

- ka pasur licencë shërbimi për shërbime të ujit dhe për ujëra të zeza nr. 203/SL/05 nga 01.11.2005 gjer më 30.04.2006;
- ka pasur licencë shërbimi për grumbullimin e mbeturinave nr. 327/SL nga 30.11.2005 gjer më 30.05.2006;

me Vendim të Rregullatorit nr. 319/SL i dt. 08.06.2006 i është përtëri licenca e shërbimit gjer më 31.12.2006;

- Vodovod "Ibar" Mitrovicë asnjëherë nuk ka aplikuar dhe nuk ka pasur licencë të shërbimit;
- JKP "Standard" Mitrovicë asnjëherë nuk ka aplikuar dhe nuk ka pasur licencë të shërbimit;

Vërejtje: Sipas të dhënave nga ARRU, pas datës 31.12.2006 kompanitë e lartë përmendura (të licencuarat dhe palicencuarat) nuk kanë aplikuar për licencim edhe përkundër insistimit të ARRU-së me procedimin e disa shkresave. Nga ajo datë nuk ka informata se kujt i raportojnë.

Tregu relevant:

-Tregu gjeografik

- o Regjioni i PRISHTINËS DHE MITROVICËS
- o Regjioni i GJAKOVËS
- o Regjioni i PEJËS

-Tregu i produktit - Uji për ujitje

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim me ujë për ujitje</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim me ujë për ujitje</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër Lepenc" SH.A. PRISHTINË	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim me ujë për ujitje</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim me ujë për ujitje</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. Kompania regjionale e ujitjes "RADONIQI-DUKAGJINI" SH.A. GJAKOVË	100%	Monopol

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun me furnizim me ujë për ujitje</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve me furnizim me ujë për ujitje</i>	<i>Pozita Dominuese >25% e tregut relevant</i>
1. Kompania regjionale e ujitjes "DRINI I BARDHË" SH.A. PEJË	100%	Monopol

Tregu relevant:

- Tregu gjeografik - REPUBLIKA E KOSOVËS
- Tregu i produktit - Prodhimi i ujit (natyral dhe me gaz) dhe pijeve freskuese të ambalazuara.

Sa i përket këtij tregu është evidente sipas të dhënave nga institucionet përkatëse del se ka konkurrencë të mjaftueshme në treg. Sipas evidencës në ARBK – MTI del se janë të licencuara 151 operator ekonomik të cilët merren me prodhimin e pijeve freskuese, prodhimin e ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe. Sipas hulumtimit është e pamundur të pasqyrojmë strukturën e saktë të tregut për shkak të sistemit të të hyrave në ATK për produktin në fjalë nga se qarkullimi vjetor është i përbashkët.

Hulumtimi i bërë nga
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për
TREGU I MBETURINAVE

Në kuadër të hulumtimit të tregut të Mbeturinave, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka zhvilluar takime me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e cila e rregullon këtë sektor. Ky treg rregullohet me Ligjin për Mbeturina i cili rregullon menaxhimin e mbeturinave, planet për menaxhimin e mjedisit, të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyra dhe kushtet e mbledhjes së mbeturinave, transportit, trajtimit, përpunimit, magazinimit dhe deponimit përfundimtar, importin, eksportin dhe transitin e mbeturinave, monitorimin, sistemin informativ dhe financimin.

Në këtë treg operojnë 85 kompani publike dhe private të licencuara nga Autoriteti përkatës. Përcaktimin e çmimeve për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave komunale e bëjnë Komunitat duke e aprovuar në asamblatë të tyre, ndërsa për llojet e tjera të mbeturinave çmimi përcaktohet në bazë të tregut. Sipas të dhënave të siguruara nga zyrtaret përkatës procesi i licencimit është i rregulluar me Udhëzimin Administrativ nr.09/2014 dhe nuk ka kufizime për futjen e operatorëve të rinj në treg.

Struktura e tregut të mbeturinave në aspektin e mbulimit të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave komunale në tere territorin e Republikës së Kosovës sipas performances të MAPL për vitin 2016 në nivel të vendit është prej 72.58%. Bazuar në të dhënat e siguruara nga rregullatorët përkatës, Autoriteti konsideron se tregu për grumbullimin e mbeturinave komunale ka kufizim të tregut. Sipas të dhënave nga hulumtimi, në shumicën e komunave kemi vetëm nga një operator publik.

Autoriteti në të kaluarën e afërt ka pas informacione se ndërmarrjet publike të cilat ushtrojnë këtë veprimtari ekonomike të kenë pozita monopoliste në ofrimin shërbimit, bartjen , grumbullim dhe deponimin e mbeturinave komunale. Ligji mbi mbeturinat nuk e kufizon këtë treg dhe nuk i vendos ndërmarrjet private në pozita të pafavorshme konkurruese.

<i>Identifikimi i ndërmarrjeve të cilat operojnë në tregun e Mbeturinave</i>	<i>Struktura e tregut të ndërmarrjeve në tregun e Mbeturinave</i>	<i>Pozita Dominuese 25% e tregut relevant</i>
1. "Rec Kos" sh.p.k.	30.58%	Ka Pozitë dominuese
2. K.r.m. "Pastrimi" SH.A.	18.94%	Nuk ka PD
3. "Plastika" Sh.p.k.	15.33%	Nuk ka PD
4. Sh.p.k. "G- Plus"	10.77%	Nuk ka PD
5. K.r.m. "Eko Regjioni" Sh.A.	9.58%	Nuk ka PD
6. Mobile Sanitary Services (MSS) Sh.p.k.	7.64%	Nuk ka PD
7. "KMI" sh.p.k.	4.69%	Nuk ka PD
8. N.t.sh. "Stina"	4.57%	Nuk ka PD
9. K.r.m. "Patërtia" SH.A.	4.57%	Nuk ka PD
10. "Eco-Higjiena" shpk	4.53%	Nuk ka PD
11. Sh.p.k. Euro Still	4.22%	Nuk ka PD
12. "Toifor" Sh.p.k.	3.99%	Nuk ka PD
13. K.r.m. "Çabрати" SH.A.	2.79%	Nuk ka PD

Rekomandimet dhe mendimet profesionale

Në bazë të të gjeturave nga Autoriteti del se tregu i mbeturinave është i liberalizuar dhe konkurrues. Legjislacioni përkatës nuk e kufizon asnjë ndërmarrje të re që të futet në treg, por gjatë analizimit dhe hulumtimit përkatës, rezultatet statistikore tregojnë se ndërmarrja "Rec Kos" Sh.p.k. rezulton me (30.58%) të pjesëmarrjes në tregun përkatës dhe sipas kësaj ky operator mbanë pozitë dominuese në këtë treg ndërsa operatorët tjerë janë në përqindje më të vogël por tregu sipas pikëpamjeve të Autoritetit është mjaftueshëm konkurrues.

Por në kuadër të grumbullimit të mbeturinave komunale, tregu përkatës është i kufizuar sepse ndërmarrjet publike janë të vetmet që ushtrojnë këtë aktivitet, për kundër faktit që legjislacioni i mbeturinave nuk ka ndonjë kufizim të tregut.

Ky treg është i rregulluar me ligj dhe akte tjera nënligjore, andaj si i tillë është i liberalizuar dhe ekziston një konkurrueshmëri e mjaftueshme, andaj Autoriteti nuk ka ndonjë rekomandim specifik për institucionet që e rregullojnë këtë treg, por nënvizon se ndërmarrjet të cilat janë në pozitë dominuese mund të abuzojnë me pozitën apo fuqinë e tyre në treg. Andaj për parandalimin e kësaj dukurie Autoriteti do të jetë në monitorim dhe koordinim të vazhdueshëm me rregullatorin përkatës. Ndërsa në kuadër të grumbullimit të mbeturinave komunale, tregu është i kufizuar, andaj Autoriteti rekomandon institucioneve rregulluese dhe Komunale që ta liberalizoj këtë treg duke krijuar kushte të favorshme konkurruese për futjen e operatorëve të rinj në këtë treg.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për bashkëpunimin efikas falenderon:

1. Administratën Tatimore të Kosovës (ATK)
2. Doganën e Kosovës
3. Bankën Qendrore të Kosovës (BQK)
4. Autoritetin Rregullativ për shërbimet e Ujit (ARRU)
5. Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)
6. Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)
7. Komisionin për Miniera dhe Mineraleve (KPMM)
8. Zyrën Rregullatore të Energjisë (ZRRE)
9. Agjencionin Kosovar për Produkte dhe Paisjeve Medicinale (AKPPM)
10. Komisionin Rregullative të Prokurimit Publik (KRPP)
11. Ministrinë e Infrastrukturës
12. Ministrinë e Financave
13. Ministrinë e Shëndetësisë
14. Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë
15. Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë